



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 11, Datë 10.01.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“LENGARICA & ENERGY” SH.P.K., PËR MIRATIMIN E VENDOSJES SË
HIPOTEKËS MBI ASETET QË DISPONON, NË FAVOR TË INTESA SANPAOLO
BANK OF ALBANIA SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16; 44 pika 1, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, pikës 1.3, të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” nenet 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 119, datë 21.07.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k për miratimin e vendosjes së hipotekës mbi asetet që disponon, në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 88, datë 07.06.2017, miratoi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k, për lënien peng të asetëve në favor të Bankave “Green For Growth Fund Southeast Europe S.A.(GGF)” dhe “Oesterreeichische Entwicklungbank AG(OeEB)”.
- Subjekti ka paraqitur kërkesën nr. 43 Prot., datë 08.11.2017 dhe dokumentacionin shoqërues për vendosje të hipotekës mbi asetet e shoqërisë, në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., për efekt të lëvrimit të një kredie për ndërtimin e Hec Lengarica.
- Shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k. dhe Banka (GGF) Green For Growth Fund Southeast Europe, kanë rënë dakort që Banka Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., të blejë kredinë e dhënë nga GGF duke u bërë palë e re, në financimin e projektit për ndërtimin e Hec Lengarica.
- Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit si më poshtë:
 - Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Neni 7 pika 3, është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Lista e asetëve për të cilat aplikuesi ka paraqitur kërkesën për miratimin e vendosjes së Hipotekës, nga ERE, ka në të asete, të cilat kanë qënë barrë hipotekore në favor të bankës (GGF) Green For Growth Fund Southeast Europe dhe AG (OeEB Oesterreeichische Entwicklungbank AG).
- Aplikuesi duhet të çlirojë asetet sa më sipër nga barra e vendosur në favor të GGF dhe OeEB referuar marrëveshjes hipotekore lidhur me datë 27.03.2014 midis subjektit dhe Bankave dhe të depozitojë në ERE vërtetimin nga hipoteka ZRPP, jo më vonë se 45 ditë nga marrja e vendimit për fillimin e procedurës së miratimit të kërkesës së transferimit të asetëve.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me Nenin 7, pika 1, gërma “c” (Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve) do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10 pika 2 të *Rregullores për Procedurat e Transferimit të Asetëve nga të Licencuarit*, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afatëve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “LENGARICA & ENERGY“ sh.p.k., për miratimin e vendosjes së Hipotekës mbi asetet që disponon, në favor të Intesa Sanpaolo Bank of Albania sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI